

REPUBLIKA E KOSOVES			
KOMUNA GLLOGOC			
GLLOGOC MUNICIPALITY			
Pranuar	16.11.2020		
Nj. Org.	Numër	Shtojca	Vlera
01-060-	48552		

PROCESVERBAL NGA TAKIMI I KËSHILLIT KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI (KKSBB)
IZVEŠTAJ O SASTANKU OPŠTINSKOG ODBORA ZA BEZBEDNOST ZAJEDNICE (OOBZ)

Komuna / Opština: Drenas Data / Datum: 11.11.2020

Numri i takimit për këtë vit / Redni broj sastanka u ovoj godini: 7

Takim i rregullt / Redovni sastanak Takim i jashtëzakonshëm / Vanredni sastanak X

Numri i anëtarëve të KKSBB-së të pranishëm / Broj prisutnih članova OOBZ: 17

**A kanë marrë pjesë në takim përfaqësuesit e komuniteteve jo shumicë, nëse janë anëtarë të KKSBB-së?
 Da li su predstavnici nevećinskih zajednica, u svojstvu članova OOBZ, prisustvovali sastanku?**

Po / Da ☐

Jo / Ne ☐

Nuk ka anëtarë që përfaqësojnë komunitetet jo shumicë/Nema članove koji predstavljaju nevećinske zajednice ☒

**A kanë marrë pjesë anëtarë të tjerë përveç anëtarëve të KKSBB-së?
 Da li je neko osim članova OOBZ prisustvovao sastanku?**

Po / Da ☒ *LMT K-9 e KFOR-it Zviceran.*

Jo / Ne ☐

*Nëse "Po", ju lutem potenconi organizatën të cilën e përfaqësojnë
 Ukoliko je odgovor "Da", molimo navedite koje organizacije predstavljaju*

**A është kryesuar takimi nga Kryetari i Komunës apo nënkryetari?
 Da li je sastankom predsedavao Gradonačelnik ili Zamenik?**

Po / Da ☒ Kryetari

Jo / Ne ☐

Temat në rendin e ditës / Teme na dnevnom redu:

Në mbledhje u diskutuan këto pika të rendit të ditës:

1. Njoftim për gjendjen epidemiologjike dhe masat e ndërmarra në Komunën e Drenasit;
2. Të ndryshme.

Ju lutem, potenconi temat tjera për të cilat është diskutuar në të ndryshmet / Molimo navedite druge teme o kojima se diskutovalo:

Konkluzionet / Zaključci:

Mbledhjen e kryesoi kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci.

Të pranishëm ishin të gjithë anëtarët e KKSBS-së apo përfaqësuesit e tyre dhe përfaqësues nga LMT e KFOR-it Zviceran.

Kryetari Lladrovci i njoftoi të pranishmit për masat e marra dhe për aktivizimin Shtabit Emergjent dhe Qendrës Emergjente Lokale dhe se Komuna është e gatshme që nëse përkeqësohet gjendja nga pandemia, rrjedhimisht nëse izolohet vendi, që t'i ndihmojnë familjet e prekura nga virusi dhe ka shtuar se vendimet e Qeverisë do të zbatohen në përpikëri. Kryetari Lladrovci i njoftoi edhe për shqetësimet e ngritura nga ana e tij në mbledhjen e fundit të Asociacionit të Komunave të Kosovës dhe falënderoi Policinë e Drenasit, FSK-në dhe KFOR-in për bashkëpunimin e deritanishëm dhe gatishmërinë për bashkëpunim dhe ndihmesë edhe në të ardhmen.

Drejtori i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Arsim Haxhiu, i ka njoftuar anëtarët e KKSBS-së me statistikën e të infektuarve. Ai ka shtuar se që nga Marsi i këtij viti deri me datën 10.11.2020 në Drenas janë prekur 548, prej tyre janë 105 raste aktive dhe 413 të tjerë janë shëruar. Haxhiu ka shtuar se ekipet mjekësore, janë të gatshme për të zbatuar rekomandimet që dalin nga niveli qendror. Gjithashtu tha se edhe një ekip nga QKMF-ja e Drenasit ndodhet edhe në aeroport.

Drejtori i Inspeksionit Milaim Hajdari i njoftoi të pranishmit për punën e kësaj drejtorie në respektim të zbatimit të rekomandimeve të IKSHPS-së dhe Ministrisë së shëndetësisë si për statistikën e inspektimeve institucioneve shkollore dhe publike. Komuna jonë është ndër komunat e pakta që lëshon aktvendim për izolim dhe përfundim të izolimit për personat e infektuar me COVID-19, tha drejtori Hajdari.

Drejtori i Drejtorisë Komunale për Arsim, Muhamet Gjoka, paraqiti një përmbledhje të situatës aktuale në shkollat e komunës sonë dhe punën që po bëhet në menaxhim të situatës. Për momentin vetëm një shkollë (Sankoc) dhe një klasë në një shkollë tjetër janë duke zhvilluar mësim online. Ai theksoi se ka një bashkëpunim të mirë të kësaj drejtorie me IKSHPS-në për testimin e mësimdhënësve dhe nxënësve të dyshuar për infektim të mundshëm me virusin COVID-19.

Për të ndryshme u ngritën disa çështje të cilat do të diskutohen në mbledhjen e ardhshme e cila do të mbahet muajin e ardhshëm si çështje në lidhje me qentë endacake dhe dukurinë e përhapjes së përdorimit të lëndëve narkotike në disa shkolla.

Procesverbali u përpilua nga koordinatori i KKSBS-së:

Izveštaj pripremio Koordinator OOBZ: Arben Shala

(emri, mbiemri dhe nënshkrimi / ime, prezime i potpis)

Procesverbali aprovohet nga Kryetari:

Izveštaj odobrava Gradonačelnik: Ramiz Lladrovci

nënshkrimi

potpis

Data e aprovimit / Datum odobravanja: 12.11.2020

Rekomandimet:

- Dërgimi i këtij procesverbali është obligim që del nga UA 27/2012 MPB – 03/2012 MAPL neni 11 pika 6;
- Procesverbali përpilohet nga koordinatori i KKSBS-së në Komunën përkatëse;
- Procesverbali duhet të dërgohet në MPB në e-mail adresën: mpb.dsb@rks-gov.net
- Procesverbali duhet të dërgohet në MAPL në e-mail adresën: Shkrimorja.Mapl@rks-gov.net
- Procesverbali duhet të dërgohet njëkohësisht me ftesën e takimit të ardhshëm të KKSBS-së.



REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA GLLOGOC GLLOGOC MUNICIPALITY			
Prantuar		06/11 20 20	
Nj. Org.	Numër	Shtojca	Vlera
01	060/01-	48552	



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA DRENAS
Zyra e Kryetarit
Drenas, më 06.11.2020

Në bazë të Udhëzimit Administrativ nr. 27/2012 MPB — 03/2012 MAPL për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi, përkatësisht nenit 9 pika 1.3, dhe Vendimit nr. 12-030-786, datës 04.01.2018, të Kuvendit Komunal, thirret mbledhja e jashtëzakonshme e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKS), në emër të Kryetarit të Komunës, Ramiz Lladrovci, ju drejtojmë këtë:

F T E S Ë

Për anëtarin/en _____ nga _____
që të marrë pjesë në mbledhjen e jashtëzakonshme të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKS) lidhur me zhvillimet e fundit në Komunën e Drenasit.

Mbledhja e rregullt mbahet më datën 11.11.2020, e mërkurë, me fillim në orën 14:00, në Sallën e mbledhjeve të Bordit të Drejtorëve.

Rendi i ditës:

1. Njoftim për gjendjen epidemiologjike dhe masat e ndërmarra në Komunën e Drenasit;
2. Të ndryshme.

Kopje: Anëtarëve të KKS-së


Kryetari i Komunës

Ramiz Lladrovci